



Ne prag të ndeshjes me Partizanin, presidenti i Kukësit Safet Gjici i ka bërë thirrje lojtareve të tij të thërrasin mendjes dhe të japin me të mirën. Investimet e tij duhen justifikuar me rezultate dhe në ndeshjen e radhës sipas presidentit duhet një skuadër bindëse. “Ka ardhur koha që të marrim një fitore me lojë dhe gola, për të treguar se në jemi ekip elitare dhe se lenia e pikeve i përket së kaluarës. Rikuperimi i tyre duhet të bëhet që në fazën e parë, duke nisur me Partizanin. Dua që ekipi të derdhe në fushë gjithë mundin dhe klasin që kërkon një ndeshje e vështirë, siç është kjo me Partizanin. Kukësi i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet që të dalë me tri pikët nga kjo përballje ndaj dua të shoh skuadrën që pashe në Europë”, është shprehur Gjici.